

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit K.C. nga fshati ..., Komuna ..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.nr.2142/17 të datës 27.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën 23.03.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I akuzuari K.C. nga babai B. dhe nëna S. e lindur V., i lindur më data e lindjes... në ..., jeton në fshatin ..., ka të mbaruar shkollën fillore, i punësuar, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së varfër ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 17 tetor 2017, rreth orës 17:35 minuta, në vendin e quajtur “ ... ”, në terrenin e fshatit ..., komuna e ..., të administruar nga Autoriteti Pyjor Komunal, zyra në Gjilan, i pandehuri K.C. me qëllim vjedhje ka prerë në mënyrë të palejueshme me sharrë motorike 83 copa trungje të llojit Bung, me diametër 10-14 cm, në lartësi prej 5 m, si dhe vëllim të përgjithshëm prej 2.07 m³, kështu që i pandehuri me veprimet e tij i ka shkaktuar të dëmtuarës ... dega në Gjilan, dëm material në vlerë prej 264,96 euro.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,7,17,21,49,50,51,52 dhe 73 KPRK si dhe nenit 365,451 KPPRK-së, i shqipton

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen tjetër veprë penale në të kundërtën dënimi me kusht ka për tu revokuar.

I dëmtuari ... i pyjeve për realizimin e kërkesës pronësore – juridike është udhëzuar në kontestin civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 euro dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate në afat prej 15 ditëve.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit K.C. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së ,

Gjatë seancës dëgjimore të mbajtur më 23.03.2018, në të cilën është lexuar aktakuza e Prokurorit të shtetit PP.nr.2142/17 prej 27.11.2017 dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri K.C. ka deklaruar që ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale që i vihet në barë, duke shtuar që pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale. Në mbrojtjen e tij ka cekur që është i gjendjes së varfër, që ka gruan e cila nuk punon dhe fëmijën, dhe që këtë është dashur ta bëjë këtë nga nevoja. Ka premtuar gjykatës që më nuk do të përsëris një gjë të tillë.

Në seancën e parë dëgjimore publike gjyqtarja individuale ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Gjyqtarja individuale ka konstatuar që i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit, që pranimi i fajësisë është i bazuar në faktet lëndore që i përmaban aktakuza dhe që aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Konform këtyre, gjyqtarja individuale ka vërtetuar gjendjen faktike si në vijim:

-që i pandehuri K.C. ka kryer veprën penale që i vihet në barë vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, në vendin dhe mënyrën si në përshkrimin e këtij aktgjykimi.

Në bazë të të gjitha të cekurave gjykata vendosi që të pandehurin K.C. ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale pasi që e njëjta përmban të gjitha elementet e kësaj veprë penale dhe për të cilën është përgjegjës.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së gjatë shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit gjyqtarja individuale ka marr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata për të pandehurin ka marr që është baba i një fëmije, që është i gjendjes tejet të varfër, që deri më tani nuk ka qenë i gjykuar.

Nga rrethanat rënduese gjykata ka marr parasysh rrezikun shoqëror të veprës dhe faktin që kjo vepër është shpesh e përfshirë.

Sipas bindjes së gjyqtarës individuale dënimi me kusht i shqiptuar ndaj të pandehurit K.C. paraqet dënim që është i drejtë konform me peshën e veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja individuale konstatoi që edhe me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së dhe që në të ardhmen i pandehuri mos të kryej vepra të tjera penale, që të parandaloj persona të tjerët që të kryejnë vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke pas parasysh natyrën e kësaj vepre penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit gjyqtarja në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta obligoj të paguaj vetëm paushallin gjyqësor në shumën prej 25 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.1287/17 të datës 23.03.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Përktheu:
Ardijana Aliu